

VENDIM
Nr. 221, datë 17.4.2025

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR OFICERËT NDËRLIDHËS TË
ATASHUAR NË VENDET E TJERA APO NË ORGANIZATA E MISIONE
NDËRKOMBËTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 9, të nenit 130, të ligjit nr. 82/2024, “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore për oficerët ndërlidhës të atashuar në vendet e tjera apo në organizata e misionet ndërkombëtare, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

RREGULLORE
**PËR OFICERËT NDËRLIDHËS TË ATASHUAR NË VENDET E TJERA APO NË
ORGANIZATA E MISIONE NDËRKOMBËTARE**

Neni 1
Objekti

Kjo rregullore ka si objekt përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësi, marrëdhënieve të varësisë e të komunikimit, procedurave të përzgjedhjes dhe emërimit/akreditimit, procedurave për marrjen, dorëzimin e detyrës dhe fushës së veprimit për oficerët ndërlidhës të ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike/Policisë së Shtetit, të atashuar/akredituar në shtetet e tjera, në organizatat ndërkombëtare ose si pjesë e një misioni ndërkombëtar.

Neni 2
Përkufizimet

Në këtë rregullore, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Oficer ndërlidhës (ON)”, punonjësi i Policisë së Shtetit, i emëruar/atashuar jashtë vendit pranë një misioni diplomatik të Republikës së Shqipërisë, organizate apo misioni ndërkombëtar.

2. “Oficeri ndërlidhës i huaj (ONH)”, përfaqësuesi i një vendi tjetër apo organizate ndërkombëtare, rezident ose jo në Shqipëri, i cili në bazë të marrëveshjeve dy- ose shumëpalëshe, është atashuar/akredituar si oficer ndërlidhës në Shqipëri.

3. “Sektori i oficerëve ndërlidhës (SON)” është në strukturat e bashkëpunimit ndërkombëtar në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

4. “Oficer ndërlidhës pranë Qendrës për Zbatimin e Ligjit të Evropës Juglindore SELEC (ONS)”, punonjësi i Policisë së Shtetit, i emëruar/atashuar pranë selisë së SELEC-it, në Bukuresht, Rumani, dhe përfaqëson Policinë e Shtetit në marrëdhëniet me këtë agjenci.

5. “Oficer ndërlidhës pranë INTERPOL-it (ONI)”, punonjësi i Policisë së Shtetit, i emëruar/ atashuar pranë selisë së INTERPOL-it, dhe përfaqëson Policinë e Shtetit në marrëdhënie me këtë agjenci.

6. “Oficer ndërlidhës pranë EUROPOL-it (ONE)”, punonjësi i Policisë së Shtetit, i emëruar/ atashuar në Zyrën Ndërlidhëse të Policisë së Shtetit pranë selisë së EUROPOL-it, në Hagë, Holandë, bazuar në marrëveshjet e Policisë së Shtetit me EUROPOL-in, si dhe përfaqëson Policinë e Shtetit në marrëdhënie me këtë agjenci.

Neni 3

Detyrat dhe përgjegjësitë e oficerit ndërlidhës

1. Oficeri ndërlidhës përfaqëson Ministrinë e Brendshme e Policinë e Shtetit, si dhe me marrëveshje edhe institucione të tjera të shtetit shqiptar në vendin pritës apo në organizatat, ku ai është akredituar. Ai shërben si këshilltar i titullarit të misionit apo përfaqësisë diplomatike në fushën e bashkëpunimit policor e të sigurisë publike në vendin apo organizatën, ku ai është akredituar.

2. Oficeri ndërlidhës është përgjegjës, për:

a) përfaqësimin e Ministrisë së Brendshme dhe Policisë së Shtetit, si dhe mbajtjen e kontakteve me autoritetet përkatëse në vendin apo organizatën pranë së cilës është atashuar;

b) koordinimin e zbatimit të detyrimeve të përcaktuara në marrëveshjet dy-ose shumëpalëshe apo aktet e tjera ndërkombëtare, të nënshkruara nga vendi ynë lidhur me bashkëpunimin ndërkombëtar policor, si dhe akte të tjera ligjore e nënligjore, që i ngarkojnë ata me detyrime;

c) mbledhjen dhe shkëmbimin e informacionit, në veçanti për të mbështetur hetimet e autoriteteve ligjzbatuese;

ç) mbështetjen e autoriteteve ligjzbatuese në vendin pritës për kryerjen e hetimeve, që kanë lidhje me Shqipërinë;

d) pritjen dhe asistimin e oficerëve të Policisë së Shtetit dhe zyrtarëve të institucioneve/ agjencive të tjera ligjzbatuese shqiptare në aktivitete zyrtare në vendin apo organizatën pritëse, në çështjet e shkëmbimit të informacionit policor, takimeve operationale dhe në ekzekutimin e letërporosive dhe ekstradimeve;

dh) përfaqësimin e vendit tonë në aktivitetet me interes, të organizuara në fushën e sigurisë publike, luftës kundër kriminalitetit dhe terrorizmit nga institucione të vendit pritës apo vende partnere;

e) informimin e titullarit të misionit diplomatik të Republikës së Shqipërisë në vendin ku është atashuar për aktivitetin e tij ditor, duke ruajtur aspektet dhe informacionin operational, si dhe kontribuon në kuadër të misionit dhe përgjegjësi të përfaqësisë diplomatike. Në këtë rast, ai bashkëpunon me stafin diplomatik që shërben në mision;

ë) respektimin e rregullave etike-formale të vendosura për stafin e misionit.

3. ON-i ushtron funksionin në bazë të procedurave standarde të punës për oficerët ndërlidhës të Policisë së Shtetit dhe detyrave të marra nga Ministria e Brendshme/Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe nga titullari i misionit apo përfaqësisë diplomatike, si dhe raporton për detyrat e marra.

4. ON-i ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me prioritetet e Ministrisë së Brendshme e të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe angazhimeve të kërkuara nga titullari i përfaqësisë diplomatike.

5. ON-i koordinon punën e punonjësve të tjerë të Policisë së Shtetit, të cilët operojnë në vendin ku ai është akredituar, bazuar në marrëveshje të veçanta për një afat të caktuar. ON-i është përgjegjës për menaxhimin dhe trajtimin e informacionit të grumbulluar nga oficerët e tjerë të Policisë së Shtetit dhe koordinon punën ndërmjet tyre dhe Policisë Shtetit.

6. ON-i merr pjesë në takime, aktivitete dhe konferenca, që kanë lidhje me policimin dhe sigurinë publike në vendin pritës. Në këto aktivitete ai prezanton, sipas rastit, arritjet më të mira të

Ministritë së Brendshme e të Policisë së Shtetit dhe informon Policinë e Shtetit për përvojat e partnerëve me interes.

7. ON-i harton, administron, analizon dhe transmeton informacionin e grumbulluar gjatë kryerjes së detyrave të tij.

8. ON-i harton informacione për probleme specifike në vendin ku është i akredituar, sa herë që i kërkohet nga autoriteti i Ministrisë së Brendshme dhe Policisë së Shtetit.

9. ON-i, në bashkëpunim me strukturat homologe të vendit pritës, kontribuon në kryerjen e analizës për tendencat kriminale, sipas fushave dhe drejtimeve të kërkuara nga Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

10. ON-i, me miratimin paraprak të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, kryen rakordimin e shpenzimeve financiare pranë strukturës përkatëse të financës në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

11. Në rastin kur ON-i akreditohet në më shumë se një vend, procedurat e veprimtarisë së punës përcaktohen me procedurë të veçantë, miratuar nga drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

12. ON-i raporton në mënyrë periodike pranë drejtorit të departamentit përgjegjës për marrëdhëniet ndërkombëtare dhe drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe sipas procedurave lidhur me veprimtarinë e tyre, realizimin e detyrave, çështjet administrative, buxhetore, financiare dhe dinamikën e punës.

13. ON-i, në zbatimin e detyrave funksionale për detyra të cilat koordinohen nga EUROPOL-i, raporton dhe koordinon me Drejtorinë e EUROPOL-it në Policinë e Shtetit.

14. ON-i shkëmben informacione, në funksion të parandalimit dhe hetimit të krimit me strukturat policore të vendit, ku janë atashuar/akredituar me Policinë e Shtetit, si dhe me institucionet e tjera kombëtare të zbatimit të ligjit. ON-i ndjek dhe përfundon praktika të ardhura apo të dërguara, si më poshtë vijon:

a) kërkesa për informacion apo veprimtari kriminale për autorët, vendndodhjen dhe kapjen e tyre, trajtimin e provave apo dokumenteve të tjera, koordinimin e operacioneve të përbashkëta policore, masat e marra nga policia e vendit përkatës, si dhe bashkëpunimi që kërkohet për zgjidhjen e problemit;

b) kërkesa për ndihmë policore, juridike e penale, të ardhura/dërguara nëpërmjet oficerëve ndërlidhës, apo çdo kërkesë tjetër që rrjedh nga konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

15. ON-i shkëmben informacion për krime të rënda apo akte terroriste me ON-in e një vendi tjetër, të akredituar në po atë vend, pasi ka marrë miratimin paraprak nga strukturat përgjegjëse të Policisë së Shtetit.

16. ON-i, për çështje me interes, merr detyra dhe raporton direkt te ministri i Brendshëm, te strukturat e caktuara prej tij apo nëpërmjet drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

17. ON-i, përveç detyrave të parashikuara në këtë nen, kryen edhe detyra shtesë të caktuara nga ministri i Brendshëm apo nga drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

Neni 4

Detyrat dhe përgjegjësitë e sektorit të oficerëve ndërlidhës në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit

1. SON-i në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit është përgjegjës për koordinimin e aktivitetit të oficerëve ndërlidhës shqiptarë, oficerëve ose zyrave ndërlidhëse të shteteve të huaja apo organizatave, të atashuar në Shqipëri, si dhe atyre jorezidentë, që përgjigjen për Shqipërinë.

2. SON-i trajton dhe administron kërkesat për informacion apo kryerjen e veprimeve të tjera hetimore të strukturave të Policisë së Shtetit, në drejtim të vendeve të tjera apo organizatave ndërkombëtare.

3. SON-i shërben si pikë kontakti ndërmjet ON-it dhe strukturave të Policisë së Shtetit për transmetimin e informacionit policor apo informacionit me karakter administrativ, me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikat 12 e 14, të nenit 3, të kësaj rregulloreje, si dhe situatave emergjente apo rrethanave, të cilat diktojnë komunikim të drejtpërdrejtë me strukturat e Policisë së Shtetit. Oficeri ndërlidhës, brenda 24 (njëzet e katër) orëve vendos në dijeni SON-in, në lidhje me përmbajtjen e informacionit të transmetuar në mënyrë të detajuar, duke arsyetuar dhe shkaku në urgjencës.

4. Mënyra e veprimit të SON-it dhe ON-it për shkëmbimin e informacionit parashikohen në procedurën standarde të punës, miratuar nga drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

Neni 5

Kriteret e përzgjedhjes

Kriteret për përzgjedhjen e ON-it përcaktohen në funksion të kërkesave, prioriteteve dhe interesave të Republikës së Shqipërisë, Ministrisë së Brendshme dhe Policisë së Shtetit, në fushën e sigurisë dhe bashkëpunimit policor. ON-i duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

- a) të jetë punonjës me gradë “Kryekomisar” deri “Drejtues i parë” në Policinë e Shtetit;
- b) të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale apo kundërvajtje penale e kryer me dashje;
- c) të mos jetë nën efektin e një mase disiplinore, të përcaktuar në shkronjat “c”, “ç”, “d”, “dh” dhe “e”, të nenit 123, të ligjit nr. 82/2024, “Për Policinë e Shtetit”;
- ç) të ketë njohuri të mira për gjuhën angleze në të tre komponentët (shkrim, lexim, e folur). Njohja e gjuhës së vendit pritës nga ana e ON-it, është përparësi;
- d) të jetë i pajisur me certifikatën e sigurisë përkatëse, të përcaktuar sipas akteve ligjore në fuqi;
- dh) të ketë përvojë pune në strukturat e Policisë së Shtetit, jo më pak se 10 (dhjetë) vjet;
- e) të ketë aftësi shumë të mira komunikimi dhe për të punuar me të tjerët;
- ë) të mos jetë në konflikt interesi me detyrën që do të kryejë;
- f) të jetë i aftë për punë nga ana shëndetësore;
- g) të jetë i pajisur me dëshmi të aftësisë së drejtimit të automjeti të tipit “B”;
- gj) të ketë eksperiencë/njohuri të thella për çështjet e bashkëpunimit ndërkombëtar policor, organizatat policore ndërkombëtare për standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut;
- h) të përfaqësojë një figurë të pastër morale dhe me nivele të larta integriteti.

Neni 6

Procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit

1. ON-i emërohet nga ministri i Brendshëm, me propozimin e drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Për emërimin e tij, njoftohen zyrtarisht ministria e vendit/vendeve ku do të atashohet apo organizata ndërkombëtare përkatëse.

2. ON-i qëndron në detyrë për një afat deri në 5 (pesë) vjet, por jo më pak se një periudhë 3-vjeçare. Kohëzgjatja e qëndrimit në detyrë, sipas kësaj pike, përcaktohet në urdhrin e emërimit të ministrit të Brendshëm për ON-in. Sipas rastit, qëndrimi në detyrë i ON-it mund të përcaktohet në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare ose ndërinstitucionale apo dhe praktikave të organizatave ndërkombëtare, ku ON-i është atashuar.

3. Policia e Shtetit përgatit planin dhe identifikon nevojat për caktimin në detyrë dhe zëvendësimin e ON-it, jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj nga koha e përfundimit të mandatit të ON-it që është në detyrë.

4. Policia e Shtetit shpall vendet vakante për aplikimin nga ana e punonjësve të Policisë së Shtetit të interesuar, me qëllim përzgjedhjen e kandidaturave që do t'i paraqiten ministrit të Brendshëm për emërim.

5. Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit, për çdo vend vakant, i paraqet ministrit të Brendshëm tri kandidatura, me qëllim përzgjedhjen dhe emërimin e tyre në detyrë.

6. Në rastet kur kërkohet zëvendësimi i ON-it, për shkaqet e parashikuara në nenin 15, të kësaj rregulloreje, Policia e Shtetit përzgjedh nga kandidatët e listës së paraqitur, sipas pikës 4, të këtij neni, për t'u emëruar në vendin apo organizatën në të cilin është krijuar vendi vakant, me qëllim vazhdimësinë e punës.

7. Emërimi, zëvendësimi dhe kthimi në atdhe i ON-it bëhet vetëm në periudhën e verës, në muajt qershor–gusht të vitit. Për rastet e parashikuara në nenin 14, të kësaj rregulloreje, zëvendësimi dhe kthimi i ON-it mund të bëhet në çdo kohë.

Neni 7

Mbarimi i mandatit

1. Jo më vonë se tre muaj përpara mbarimit të afatit të qëndrimit në detyrë, Policia e Shtetit e njofton ON-in për datën e saktë të lirimit nga detyra dhe kthimin e tij në atdhe.

2. Pas mbarimit të mandatit, ON-i rikthehet në strukturat e Policisë së Shtetit, në një funksion në përputhje me gradën policore që mban.

3. Punonjësi i Policisë së Shtetit mund të riemërohet ON në një shtet tjetër apo organizatë ndërkombëtare, vetëm pasi të ketë shërbyer në strukturat e Policisë së Shtetit, brenda vendit, për një periudhë jo më pak se 2 (dy) vjet, pas kthimit nga misioni i fundit.

4. Oficeri ndërlidhës, në rastin kur përfundon misionin, duhet të zbatojë detyrimet e përcaktuara sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi për dorëzimin e detyrës dhe ndërprerjen e privilegjeve të gëzuara, për shkak të funksionit që ka mbajtur si ON.

Neni 8

Procedurat e akreditimit dhe pajisja me pasaportë diplomatike/shërbimi

Pas emërimit të ON-it, Ministria e Brendshme ndjek procedurat, që lidhen me:

- a) njoftimin e ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme për emërimin e ON-it;
- b) akreditimin e ON-it të emëruar;
- c) nxjerrjen e urdhrat përkatës të ministrit përgjegjës për punët e jashtme;
- ç) pajisjen nga ministria përgjegjëse për punët e jashtme me pasaportën përkatëse (diplomatike/shërbimi) të ON-it dhe të pjesëtarëve të familjes së tij, bazuar në parashikimet e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 9

Marrëdhëniet e varësisë dhe komunikimit

1. ON-i është pjesë e strukturës organike të Policisë së Shtetit.

2. ON-i respekton titullarin e misionit diplomatik të Republikës së Shqipërisë në vendin ku është akredituar dhe stafin diplomatik, që shërben në mision. Gjithashtu, ON-i respekton rregullat formale të vendosura për stafin e misionit, si rregullat e hyrje-daljeve, orarin zyrtar, kodin e veshjes etj.

3. Mënyra e komunikimit të ON-ve të atashuar në vendet e tjera apo organizatat ndërkombëtare me partnerët ndërkombëtarë bëhet në bazë të marrëveshjeve përkatëse dhe sipas kriterëve të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe sigurisë publike, për ato çështje që nuk zgjidhen nga marrëveshja përkatëse.

4. Në çdo rast, ON-i ndalohej të komunikojë me strukturat e Policisë së Shtetit, palë të treta, ON-e të vendeve të BE-së, vende të tjera partnere apo organizatat ndërkombëtare, në mënyrë private apo kanale të paautorizuara ose jozyrtare komunikimi jashtë 2 (dy) kanaleve zyrtare të

komunikimit (poste elektronike dhe telefon), pa marrë paraprkisht miratimin e eprorit të drejtpërdrejtë.

5. ON-i, në takimet dhe kontaktet me të huajt, duhet t'u përmbahet normave të etikës së sjelljes dhe qëndrimit zyrtar të Policisë së Shtetit Shqiptar për çështjet në diskutim.

6. ON-i duhet të shmangë veprimet diskriminuese në bazë të moshës, gjinisë, racës, kombësisë, gjuhës, orientimit seksual, aftësisë së kufizuar fizike apo mendore, bindjes politike, përkatësisë etnike dhe fetare ose sociale.

7. Vlerësimi i punës së ON-it kryhet nga shefi i sektorit të SON-it dhe administrohet në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të Policisë së Shtetit, bazuar në aktet nënligjore në fuqi.

Neni 10

Procedurat për marrjen dhe dorëzimin e detyrës

Oficeri ndërlidhës, të cilit i është komunikuar urdhri i lirimit nga detyra dhe i kthimit në atdhe, ndjek procedurat e mëposhtme për dorëzimin e detyrës:

a) përgatit një përshkrim të detyrave në ndjekje, statusit të tyre dhe kushteve të punës dhe ia dorëzon ato ON-it zëvendësues;

b) i dorëzon ON-it zëvendësues të gjitha kontaktet e tij zyrtare me institucionet dhe agjencitë homologe të vendit apo organizatës pritëse;

c) i dorëzon ON-it që merr detyrën informacion të detajuar për gjendjen e marrëdhënieve në fushën e sigurisë me shtetin/organizatën ndërkombëtare, ku është akredituar;

ç) ON-i dorëzues/marrës zhvillon takime prezantimi/lamtumire me drejtues/përfaqësues të strukturave policore apo të agjencive të zbatimit të ligjit në vendin pritës;

d) i dorëzon ON-it zëvendësues inventarin e pajisjeve dhe materialeve (zyrë, automjet, numër telefoni zyrtar etj.) gjendjen e tyre sasiore e cilësore dhe së bashku firmosin procesverbalin përkatës për marrjen/dorëzimin e tyre;

dh) dorëzon me procesverbal të marrësi i detyrës dokumentacionin përkatës, planet e punës, analizat, marrëveshjet, protokollet, praktikat e informacioneve të mbyllura apo në ndjekje, së bashku me regjistrin e informacioneve, gjithashtu edhe materialet që ndodhen në kompjuterin e zyrës;

e) likuidon të gjitha detyrimet financiare me misionin/postin, si dhe subjektet, operatorët e ofrimit të shërbimeve në shtetin/organizatën, ku ka ushtruar detyrën;

ë) ON-i, dorëzues/marrës, harton procesverbalin përfundimtar për dorëzimin/marrjen e detyrës, të cilit i bashkëngjiten edhe procesverbale apo aktdorëzimet e veçanta të përmendura më sipër. Kopje të këtij procesverballi dorëzohen te titullari i misionit diplomatik në vendin pritës dhe në SON;

f) ON-i dorëzues asiston ON-in marrës edhe për probleme të tjera, siç janë akomodimi i familjes, shkollat e fëmijëve, dokumentet e nevojshme, si dhe çdo informacion tjetër në interes të qëndrimit të tij në vendin pritës;

g) procedurat e dorëzimit dhe marrjes së detyrës mund të zgjasin 1 (një) deri në 2 (dy) javë;

gj) ON-i njofton Policinë e Shtetit për marrjen e detyrës, jo më vonë se 2 (dy) javë nga paraqitja në detyrë.

Neni 11

Ruajtja e sekretit profesional

1. ON-i i qëndron besnik Republikës së Shqipërisë dhe Policisë së Shtetit. Ai zbaton detyrat me besnikëri dhe në përputhje me ligjin, me urdhrat dhe udhëzimet e eprorëve.

2. ON-i gjatë dhe jashtë ushtrimit të detyrës sigurohet të ruajë reputacionin e tij dhe të Policisë së Shtetit.

3. Komunikimi i ON-it, qofshin biseda apo shkëmbim dokumentesh, duhet të jetë i koduar dhe të ndjekë procedura të sigurta. Shkëmbimi i informacionit duhet të bëhet përmes kanaleve të sigurta dhe të autorizuar.

4. ON-i duhet të jetë i kujdesshëm edhe në komunikimet joformale për të siguruar që asnjë informacion sensitiv të mos zbulohet aksidentalisht.

5. ON-i merr masa, që informacionet e marra gjatë dhe për shkak të detyrës në periudhën e ushtrimit të funksionit të tij:

a) të jenë të sigurta dhe mbrohen nga mospërhapja e paautorizuar te personat e tretë, detyrim ky që vazhdon edhe pasi ai ndërpret marrëdhëniet e punës;

b) nuk e përdor informacionin e mbledhur për shkak të detyrës për qëllime të tjera, jashtë atyre të përcaktuara me ligj;

c) siguron mbrojtjen dhe mospërhapjen e të dhënave personale të personave, të mbrojtura sipas ligjit, me të cilat njihet gjatë ushtrimit të detyrës.

6. ON-i raporton menjëherë çdo shkelje të sekretit profesional, si dhe çdo incident që mund të rezultojë në komprometimin e informacionit të klasifikuar. Ai bashkëpunon plotësisht me hetimet e brendshme për të identifikuar burimin e çdo shkeljeje të mundshme dhe për të siguruar masa parandaluese në të ardhmen.

7. ON-i mund të transportojë pajisje elektronike zyrtare, si laptopë të koduar, dokumente të klasifikuara dhe pajisje të tjera teknike, që janë të nevojshme për detyrën e tij. Këto pajisje duhet të deklarohen dhe të mbrohen gjatë udhëtimit, në përputhje me protokollin e sigurisë dhe legjislacionin për informacionin e klasifikuar.

8. Dokumentet që përmbajnë informacion të klasifikuar transportohen vetëm duke zbatuar rregullat e transportimit të informacionit të klasifikuar, sipas parashikimeve të neneve 38 dhe 39 të rregullores “Për klasifikimin, punën, transportimin fizik, deklasifikimin, zhvlerësimin, asgjësimin dhe shkatërrimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” të NATO-s, të Bashkimit Evropian, të shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare”, të miratuar me vendimin nr. 822, datë 26.12.2024, të Këshillit të Ministrave.

Neni 12

Udhëtimet në Shqipëri dhe jashtë territorit të vendit, ku është atashuar

1. Gjatë kohës së qëndrimit të tij në detyrë ON-i mund të udhëtojë në Shqipëri ose në një vend tjetër jashtë territorit të shtetit, ku ndodhet misioni diplomatik, për arsye pune dhe/ose për arsye personale/familjare. Kur ON-i udhëton jashtë territorit të vendit, ku është akredituar për arsye personale/familjare jorgjente, duhet të planifikojë udhëtimin në një kohë të përshtatshme, pa cenuar apo ndikuar pa procesin e punës.

2. Në secilin rast, që ON-i udhëton jashtë misionit për arsye pune ashtu edhe për arsye personale, duhet të njoftojë titullarin e misionit diplomatik ku është akredituar dhe Policinë e Shtetit, duke u vënë në dispozicion edhe adresën e vendit, ku udhëton dhe të gjitha mënyrat e mbajtjes së komunikimit gjatë periudhës që ai është i larguar.

3. Në rastet kur ON-i udhëton në Shqipëri apo jashtë vendit, ku është akredituar për çështje pune, ai dërgon kërkesë zyrtare në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë para datës së udhëtimit, duke informuar për arsyen e udhëtimit, kohën kur planifikon të udhëtojë, si dhe vlerën e përafërt të shpenzimeve të udhëtimit dhe akomodimit.

4. Policia e Shtetit miraton ose refuzon kërkesën për lëvizje brenda një afati prej 10 (dhjetë) ditësh pune, me qëllim dhënien e mundësisë ON-it të planifikojë, të koordinojë dhe të konfirmojë udhëtimin tek organizatorët. Nëse ON-i nuk merr përgjigje brenda afatit të përcaktuar më lart, kërkesa konsiderohet e miratuar dhe shpenzimet e udhëtimit përballohen nga Policia e Shtetit.

Neni 13

Kufizimet për oficerin ndërlidhës

1. Oficerit ndërlidhës i ndalohet:

a) të përdorë emrin e misionit dhe statusin e tij për të realizuar aktivitete private, me qëllime përfitimi ose për të ndërhyrë në interes të personave të tjerë;

b) të ushtrojë direkt ose indirekt një profesion apo veprimtari tjetër zyrtare apo private fitimprurëse, brenda juridiksionit të vendit ku është akredituar;

c) të botojë artikuj e të japë intervista, të cilat kanë të bëjnë me detyrën, për median e shkruar apo elektronike, pa marrë miratimin e titullarit të misionit diplomatik, ku ushtron detyrën. Në çdo rast, duhet të informojë Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit;

ç) të kryejë veprimtari gjurmuese - policore dhe procedurale, që kanë të bëjnë me arrestime, ndalime dhe kontrolle të ndryshme, brenda territorit të vendit, ku janë akredituar apo përdorimin e forcës etj.

2. Përveç kufizimeve të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, ON-i është i detyruar të zbatojë detyrimet e parashikuara në nenin 51, të ligjit nr.23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”.

Neni 14

Mbarimi i parakohshëm i mandatit

Me propozim të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, ministri i Brendshëm urdhëron kthimin nga misioni përpara mbarimit të afatit të caktuar, për arsyt e mëposhtme:

a) kur nuk përmbush objektivat dhe prioritetet e përcaktuara nga Policia e Shtetit;

b) kur largimi i tij kërkohet në mënyrë të argumentuar nga shteti pritës;

c) kur ON-i ose anëtarët e familjes së tij kryejnë veprime, që janë në kundërshtim me politikën e jashtme dhe cenojnë imazhin e vendit tonë apo të institucionit të Ministrisë së Brendshme/Policisë së Shtetit;

ç) kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale apo kundërvajtjeje penale, e kryer me dashje;

d) kur i hiqet e drejta e ushtrimit të detyrës në administratën publike me vendim gjyqësor të formës së prerë;

dh) në bazë të kërkesës së vetë personit (ON);

e) kur del në lirim;

ë) kur plotëson moshën për pension;

f) kur pezullohet nga detyra;

g) kur gjendja e paaftësisë shëndetësore pengon në mënyrë të përhershme përmbushjen e detyrave të tij funksionale;

gj) kur ndahet nga jeta;

h) kur ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit me detyrën që kryen.